



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2019

Nr.re.:RK 1452/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI21/18

Parashtrues

Jakup Siqani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CN. nr. 10/2017, të 13 nëntorit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.1298/2016, të 21 gushtit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Jakup Siqani nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [CN. nr. 10/2017] e 13 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) dhe Aktvendimin [Ac. nr. 1298/2016] e 21 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C. nr. 644/2014] e 11 janarit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 22 shkurt 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përberë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 26 shkurt 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
9. Më 2 mars 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë plotësuese përmes së cilës i plotësoi pretendimet e tij të paraqitura në kërkesën fillestare.

10. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
11. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Latifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Nexhmi Rexhepi dhe Remzije Istrefi-Peci.
12. Më 23 shtator 2018, duke qenë se katër gjyqtarëve të lartpërmendur u kaloi mandati i tyre si gjyqtarë të Gjykatës, Kryetarja e Gjykatës, në bazë të Ligjit dhe Rregullores së punës, nxori Vendimin KSH.KI21/18, për caktimin e Kolegjit të ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci.
13. Më 11 shtator 2019, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues, njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 12 mars 2007, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e blerësit, lidhi Kontratën për shitblerje me N.SH. “Elektrotehna” me seli në Beograd, në cilësinë e shitësit, përkitazi me një pasuri të paluajtshme e cila ndodhet në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Kontrata). Kjo Kontratë, në të njëjtën ditë, u vërtetua në Gjykatën Komunale në Beograd me shenjën “OV. nr. 4127/0”. Më 2 dhjetor 2013 ishte nënshkruar edhe një Aneks i Kontratës së lartpërmendur me shenjën “OV. nr. 217987/2013” (në tekstin e mëtejme: Aneksi i Kontratës). I njëjti ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale në Beograd.
15. Më 30 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë me propozimin për njohjen e Kontratës dhe Aneksit përkatës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Beograd, më 12 mars 2007 dhe 2 dhjetor 2013, respektivisht.
16. Më 11 janar 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C. nr. 644/2014] e refuzoi kërkesën e parashtruesit duke arsyetuar se Kontrata përkatëse nuk është vendim gjyqësor. Përmes Aktvendimit përkatës, duke u bazuar në nenin 11 (Jurisdikcioni i Gjykatës Themelore sipas Lëndës) të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatat); nenet 3 (Zbatimi përshtatshëmrisht i ligjit për procedurën Kontestimore), 11 (Vendosja mbi çështjen jashtë seancës), 14 (Kompetenca territoriale) dhe 19 (Suspendiviteti i ankimit) të Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (në tekstin e mëtejme: LPJ) dhe nenet 86, 87 dhe 93 të Ligjit mbi shqyrtimin e konflikteve të ligjeve dhe dispozitave të huaja të vitit 1982, Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi se (i) në procedurën e njohjes së vendimeve të huaja, gjykata vendos për njohjen e tyre në rastet kur organet e shteteve të huaja janë kompetente për të vendosur për çështje familjare dhe vetëm kur “*kemi të bëjmë me aktgjykime, aktvendime dhe akte noteriale*”; (ii) Kontrata njohja e të cilës kërkohej ishte vetëm “*legalizim i nënshkrimeve në mes palëve kontraktuese*”; për më tepër, (iii) duke marrë parasysh që pasuria e paluajtshme gjendet në Republikën e Kosovës, kompetente për legalizimin e nënshkrimeve përkatëse ishte Gjykata Komunale në Prishtinë dhe jo ajo në Beograd; dhe (iv) duke

marrë parasysh faktin se Kontrata është lidhur me një ndërmarrje shoqërore, kërkesat dhe procedurat përkatëse do të duhej të ishin adresuar në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM). Përkundër refuzimit të njohjes së Kontratës përkatëse, Gjykata Themelore kishte theksuar se parashtruesi i kërkesës mund të fillojë procedurën kontestimore për njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë përkatëse.

17. Më 24 mars 2016, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e tij të pranohet si e bazuar dhe që Aktvendimi i kontestuar të ndryshohet në mënyrë që Kontrata dhe Aneksi i saj të pranohen si vendime të huaja gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës përmes kësaj anekese, ndër të tjera, specifikisht pretendoi se (i) ai e ka blerë pasurinë e paluajtshme përmes ankandit publik për shitjen e pasurive të paluajtshme nga N.SH. “Elektrotehna” e cila ishte në falimentim dhe bazuar në Aktvendimin [VII. St. 773/02] e 18 dhjetorit 2006 të Gjykatës Tregtare të Beogradit; dhe (ii) më 25 janar 2007 ishte shpallur fitues i ankandit të lartcekur, siç vërtetohet edhe nga Komisioni për shitjen e pasurive të paluajtshme të N.SH. “Elektrotehna” e të caktuar nga Kolegji për Falimentim i Gjykatës së lartcekur Tregtare. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte kontestuar konstatimet e Gjykatës Themelore përkitazi me (i) mos pranimin e Kontratës përkatëse si vendim gjyqësor; dhe (ii) kompetencën territoriale të Gjykatës Komunale në Beograd. Përkitazi me të parën, parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se duke marrë parasysh që zbatimi i procedurës së falimentimit është bazuar në Aktvendimin [VII.St.773/02] e 18 dhjetorit 2006 të Gjykatës Tregëtare të Beogradit, Kontrata përkatëse e shitblerjes është e bazuar në një vendim gjyqësor; ndërsa përkitazi me të dytën, ai kishte theksuar se duke marrë parasysh që selia e ndërmarrjes shoqërore në falimentim ka qenë në Beograd, kompetente për zbatimin e procedurës së falimentimit ka qenë gjykata përkatëse në Beograd. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte kontestuar kompetencën e AKM-së përkitazi me rastin e tij.
18. Më 21 gusht 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 1298/2016] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konfirmoi konstatimet e Gjykatës Themelore përkitazi me natyrën e Kontratës në fjalë dhe kompetencën territoriale.
19. Më 27 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme “*kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit*” [Ac.nr. 1298/2016] të Gjykatës së Apelit, duke përsëritur pretendimet e njëjta ankimore.
20. Më 13 nëntor 2017, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 10/2017] e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit [Ac. nr. 1298/2016] të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme arsyetoi se “*kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktvendimit*” nuk paraqet mjet juridik bazuar në ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, respektivisht bazuar në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [Rev. nr. 10/2017] i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara me nenet 3, 7, 31 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenet 6, 13 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
22. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon shkeljet e pretenduara të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, por ai në esencë pretendon se me hedhjen poshtë të *“kërkesës së tij për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit”*, Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me Kushtetutë sepse, sipas pretendimit, ajo ka aplikuar ligjin e gabuar në rastin e tij, respektivisht LPK-në në vend të LPJ-së. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës specifikisht thekson se *“objekt i kontestit ka qenë i procedurës jashtkontestimore, e jo i procedurës kontestimore, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës, e ka hudhur poshtë si të palejuar Kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.”*
23. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu para Gjykatës përsërit pretendimet që kishte paraqitur para gjykatave të rregullta përkitazi (i) me natyrën e Kontratës dhe pretendimeve të tij se e njëjta duhet të trajtohet si vendim gjyqësor dhe rrjedhimisht të njihet përmes gjykatave në Republikën e Kosovës; dhe (ii) kompetencën territoriale të gjykatave në Beograd për të vërtetuar Kontratën përkatëse. Përkitazi me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson para Gjykatës se rrethanat e rastit konkret nuk përkojnë me *“me shitblerje klasike të paluajtshmërisë, e cila do të impononte zbatimin e dispozitave të Ligjit në fuqi mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve”* e përmes të cilave kompetente do të ishte gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria. Për më tepër, sipas pretendimit, *“veprimet juridike për shitblerjen e pronës në procedurë të falimentimit, të zbatuar nga Gjykata Tregtare në Beograd (Republika e Serbisë), kanë ndodhur para se Kosova të shpallë pavarësinë”*, fakt ky i cili sipas parashtruesit të kërkesës nuk është marrë parasysh nga gjykatat e rregullta përgjatë vendimmarrjes së tyre.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të deklaroj kërkesën e tij të pranueshme, dhe të shpallë të pavlefshme Aktvendimin [CN. nr. 10/2017] e 13 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme dhe Aktvendimin [Ac. nr. 1298/2016] e 21 gushtit 2016 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [C. nr. 644/2014] e 11 janarit 2016 të Gjykatës Themelore, ose të kthejë çështjen e tij për rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç është parashikuar më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [CN.nr.10/2017] e 13 nëntorit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit.
29. Gjykata në vijim gjithashtu duhet të shqyrtoj nëse janë përmbushur edhe kriteret e përcaktuara në nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe paragrafin (1) (c) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtresit, dhe [...].”

30. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se në vitin 2007, parashtresi i kërkesës kishte lidhur një Kontratë me N.SH. “Elektrotehna”, me seli në Beograd, për shitblerjen e një prone të paluajtshme në Prishtinë. Më pas, në vitin 2013, ai kishte lidhur edhe një Aneks të Kontratës. Të dy këto dokumente i kishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Beograd. Gjykata më tutje rikujton se procedurat para gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës kishin filluar në momentin kur parashtresi i kërkesës, në vitin 2014, kishte paraqitur një kërkesë për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, përkatësisht Kontratës dhe Aneksit të Kontratës të përmendura më sipër. Pas shqyrtimit të kërkesës së tij, Gjykata Themelore ia kishte refuzuar kërkesën si të pabazuar duke arsyetuar, në mes tjerash, se Kontrata njohja e të cilës ishte kërkuar nuk paraqiste vendim të huaj gjyqësor dhe si e tillë nuk mund të njihej në përputhje me ligjet dhe procedurat e parapara për njohje të vendimeve gjyqësore. Më tej, parashtresi i kërkesës ishte ankuar në Gjykatën e Apelit e cila gjithashtu ia kishte refuzuar ankesën si të pabazuar, duke mbështetur arsyetimin e Gjykatës Themelore. Së fundmi, Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën e parashtresit të kërkesës duke theksuar se “*kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit*”, e të cilën parashtresi i kërkesës e kishte paraqitur para Gjykatës Supreme, nuk është lloj i kërkesës që është i përcaktuar si mjet juridik në përputhje me LPK-në. Këtë konstatim parashtresi i kërkesës e konteston në Gjykatë, duke pretenduar se Gjykata Supreme ka aplikuar ligjin e gabuar, respektivisht LPK-në në vend të LPJ-së.
31. Megjithatë, dhe siç është cekur më lart, në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara përmes nenit 49 të Ligjit në lidhje me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë fillimisht nëse kriteri për afatin 4 (katër) mujor i përcaktuar në Ligj dhe Rregullore të punës është respektuar në raport me *„vendimin e mjetit të fundit efektiv juridik”*.
32. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të vlerësojë nëse vendimi i kontestuar, përkatësisht Aktvendimi [CN.nr.10/2017] i 13 nëntorit 2017 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë si rezultat i mjetit juridik efektiv, respektivisht, nëse “*kërkesa për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit*” e ushtruar kundër Aktvendimit [Ac. nr. 1298/2016] të 21 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit, ishte mjet juridik efektiv i përcaktuar me ligj.
33. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut të

garantuara me Kushtetutë. Kjo praktikë gjyqësore, ndër të tjera, i përcakton parimet themelore në bazë të të cilave llogaritet kriteri përkitazi me afatin kohor gjashtë (6) mujor në kontekst të KEDNJ-së. (Për më shumë në lidhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së lidhur me rregullin e afatit 6 mujor, shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2019; I. Bazat Procedurale për Papranueshmëri; B. Mos-respektimi i Rregullit gjashtë mujor).

34. Qëllimi kryesor i këtij rregulli është të ruaj sigurinë juridike duke siguruar që rastet që ngrenë çështje sipas KEDNJ-së të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe të parandaloj që autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafi 258; dhe *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 19 nëntorit 2017, paragrafi 129; shih, gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, nr. KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24; e rastin KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39). Ky rregull gjithashtu i mundëson parashtruesit të mundshëm të kërkesës kohë të mjaftueshme për të vendosur nëse do të paraqesë një kërkesë dhe, nëse po, të pregaditë argumentet specifike që do të ngrihen, pasi që me kalimin e kohës, çdo ekzaminim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39).
35. Rregulli i lartcekur gjithashtu përcakton kufirin e përkohshëm të mbikëqyrjes së ushtruar nga Gjykata dhe u sinjalizon, si individëve ashtu edhe autoriteteve shtetërore, afatin përtej të cilit një mbikëqyrje e tillë nuk është më e mundur. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Idalov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 22 majit 2012, paragrafi 128; *Sabri Güneş kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 40; dhe *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 129).
36. Ky afat, gjashtë (6) mujor në kontekst të KEDNJ-së dhe katër (4) mujor në kontekst të Kushtetutës, rrjedh nga vendimi i fundit i nxjerrë si rezultat i një mjeti efektiv juridik. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edvard kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 14 marsit 2002; dhe *Lekić kundër Sllovenisë*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 65). Ky i fundit është pika fillestare për llogaritjen e afatit të pranueshmërisë. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Jeronovičs kundër Letonisë*, Aktgjykim i 5 korrikut 2016, paragrafi 75; dhe *Alekseyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim i 21 tetorit 2010, paragrafët 10-16). Për më tepër, duhet të ritheksohet se vetëm mjetet juridike të cilat janë efektive mund të merren parasysh, sepse një parashtrues i kërkesës nuk mund të zgjasë afatin e saktë të vendosur nga sistemi kushtetues dhe ai i KEDNJ-së, duke u përpjekur të parashtrojë kërkesa të papërshtatshme ose të keqkuptuara në organe ose institucione të cilat nuk kanë autoritet ose kompetencë për të ofruar korrigjim efektiv për ankesën në fjalë sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 132).

37. Gjkata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, kundër Aktvendimit [Ac.nr. 1298/2016] të 17 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën Supreme, parashtuesi i kërkesës kishte paraqitur *“kërkesë për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit”*.
38. Gjkata gjithashtu rikujton se Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit të saj, kishte shpallur kërkesën e parashtuesit të kërkesës si të palejuar me arsyetimin se *“kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit”* të Gjykatës së Apelit nuk paraqet mjet juridik të lejuar me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Më saktësisht, Gjykata Supreme e arsyetoi refuzimin e kërkesës së parashtuesit të kërkesës në aspekt procedural të pranueshmërisë me arsyetimin vijues:

“[...] Kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktvendimit është e palejuar.

Kështu sepse, sikundër dihet, me dt. 1.01.2013 ka hyrë në fuqi Ligji mbi Gjykatat i Republikës së Kosovës nr. 03/L-199, i cili me nenin 22 par.1 p.1 përcakton kompetencën e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila vendos lidhur me mjetet e jashtëzakonshme kundër vendimeve të formës së prerë të Gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me Ligj. Ndërkohë që, me Kreun XIV të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L0006, i cili ka hyrë në fuqi me dt. 05.10.2008, si mjete të jashtëzakonshme juridike janë paraparë revizioni, përsëritja e procedurës dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga fakti se me Ligjin i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës nuk është paraparë si mjet juridik edhe kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktvendimit, Gjykata Supreme e Kosovës, në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

39. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit të saj, kishte theksuar se bazuar në LPK, një mjet i tillë juridik nuk ekziston. Gjykata Supreme në mbështetje të këtij arsyetimi iu kishte referuar Kreut XIV të LPK-së, i cili përcakton (i) revizionin; (ii) përsëritjen e procedurës; dhe (iii) kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjete të jashtëzakonshme juridike. Parashtuesi i kërkesës nuk kishte paraqitur asnjërin prej tyre, dhe rrjedhimisht Gjykata Supreme kishte shpallur kërkesën e tij si të palejuar.
40. Gjykata rikujton faktin se parashtuesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka zbatuar ligjin e gabuar në rastin e tij, dhe se në vend të LPK-së, do të duhej të aplikohet LPJ. Megjithatë, Gjykata vëren se *“kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit”* nuk është e përcaktuar as me LPJ-në. Kjo e fundit, në nenet 27 dhe 28 të tij dhe nën kushtet e përcaktuar në to, përcakton (i) revizionin; dhe (ii) përsëritjen e procedurës, si mjete juridike në procedurë jokontestimore përmes të cilave mund të kontestohet një Aktvendim i formës së prerë. Parashtuesi i kërkesës nuk kishte përdorur asnjërin prej tyre kundër Aktvendimit [Ac.1298/2016] të 21 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit në Gjykatë Supreme. Për më tepër, Gjykata thekson se bazuar në nenin 3 (Zbatimi përshtatshëm i ligjit për procedurën

Kontestimore) të LPJ-së, në procedurën jokontestimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe.

41. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se "*kërkesa për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit*" nuk është mjet juridik i përcaktuar më ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Për të njëjtat arsye, edhe Gjykata Supreme kishte refuzuar "*kërkesën për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit*" si të palejuar. Për pasojë, Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë si rezultat i një mjeti juridik efektiv dhe nuk përmbush kriteret e përcaktuara përmes praktikës së Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, për të u konsideruar "*vendim përfundimtarë*". Vendimi përfundimtarë, në rrethanat e rastit konkret, është Aktvendimi [Ac.nr.1298/2016] i 17 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit, sepse është vendimi i fundit i nxjerrë si rezultat i një mjeti juridik efektiv.
42. Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar në Gjykatë dëshminë së kur e ka pranuar këtë Aktvendim të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës, "*kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit*" e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme më 27 shtator 2017. Edhe po të llogaritej kjo e fundit si data kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, kërkesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë kundër këtij Aktvendimi është parashtruar më 20 shkurt 2018, dhe rrjedhimisht jashtë afatit 4 (katër) mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës. (Shih, për kontekst të ngjashëm, rastin e Gjykatës KI19/19 dhe KI20/19, me parashtrues *Muhamet Thaqi dhe Egzon Keqa*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 49).
43. Gjykata gjithashtu thekson se pas pranimit të Aktvendimit [Ac.nr. 1298/2016] të 17 gushtit 2017 të Gjykatës së Apelit, asgjë nuk e ka penguar parashtruesin e kërkesës për t'iu drejtuar Gjykatës me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit në fjalë të Gjykatës së Apelit. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë këtë dhe duke shfrytëzuar një mjet juridik që nuk është paraparë me ligj, dhe rrjedhimisht është joefektiv, ai ka humbur afatin prej 4 (katër) muajsh, për t'iu drejtuar me kërkesë Gjykatës. (Shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, parashtruesi i kërkesës *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
44. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje kushtetuese.
45. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, si e paafatshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi